



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:111426

Datë: 22.09.2023

Numri i dokumentit: 04709879

P.nr.1284/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i çështjes Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, në çështjen penale kundër të akuzuarit Milovan Petrovi, te akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.nr.II.4851/2015 të datës: 11.03.2016, për veprën penale ”Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme” nga neni 332 par.2 nën par.2.1 të KPRK-se, gjykata jashtë seancës, më datë: 22.09.2023 mori këtë:

A K T V E N D I M

PUSHOHET procedura penale kundër të akuzuarit **M.P**, i lindur me ... në fshatin ..., komuna ..., i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, serb, me numër të letërnjoftimit ..., Shtetas i Republikës së Kosovës.

Për shkak se i pandehuri M.P, ka vdekur gjatë rrjedhës së procedurës penale, me datë 16.05.2023.

Shpenzimet e procedurës bien mbi barrën e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Pala e dëmtuar, Administrata Tatimore e Kosovës, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm në Prishtinë, me aktakuzën PP.nr.4851/2015 e datës 11.03.2016, ka akuzuar të pandehurin “Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme” nga neni 332 par.2 nën par 2.1 të KPRK-se.

Gjykata ka caktuar mbajtjen e seancës së shqyrtimit fillestar me datë: 17.08.2023 ku për të pandehurin M.P u njoftua nga i biri i tij P.P, se i njëjti ka vdekur me date 30.04.2023.

Gjykata pranoi certifikatën e vdekjes për te pandehurin M.P, Certifikata me numër ..., me numër reference ... të datës 17.08.2023, nga i cili është vërtetua se i njëjti ka vdekur me datën 30.04.2023.

Duke u bazuar në këto fakte, gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të pandehurit të pushohet procedura penale, konform nenit 158 të KPPRK-së.

Mbi shpenzimet e procedurës penale është vendosur në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Udhëzimin e të dëmtuarit, në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata e mori duke u bazuar në nenin 462 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitivi të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE
– DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
P.nr.1284/16, dt. 22.09.2023

G j y q t a r i

Sabit Sadikaj Prishtine

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 (tri) ditësh, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.